

AKSIONI KUNDËR INFORMALITETIT

Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial, në bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, bllokuan 298 ton karburant, në një vendburim në Bashkinë Finiq, e cila ishte jashtë standardeve të tregtimit. Nga kontrolli i ushtruar në këtë vendburim u konstatua se mungonte vërtetimi teknik si dhe u evidentuan probleme me cilësinë e produktit. Kontrollat në tregun e hidrokarbureve do të vijojnë.

GARANTIMI I INTEGRITETIT

MIE dhe Ambasada Holandeze në Shqipëri nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit, i cili hap rrugë realizimit të një projekti pilot, me synim promovimin dhe garantimin e integritetit dhe ndjekjes së praktikave më të mira ndërkombëtare të mirëqeverisjes në sektorin publik. Përmes këtij memorandumi, MIE angazhohet të ndërmarrë veprimet e nevojshme, që adresojnë çështjet e pajtueshmërisë dhe garantimit të integritetit duke nxitur një kulturë të re qeverisjes.

BYPASS-I I TEPELENËS

Në bypass-in e Tepelenës punimet po vijojnë me intensitet në të gjithë gjatësinë e tij dhe tashmë, kanë përfunduar afro 71 përqind e tyre. Punimet për mbrojtjen lumore kanë përfunduar plotësisht, ndërsa po vijon puna në kilometrin e parë dhe të dytë. Ndërtimi kësaj vepre lidh dy segmente, Levan-Tepelenë dhe Tepelenë-Kakavijë, duke lehtësuar qarkullimin por njëkohësisht duke rritur edhe sigurinë rrugore.

INVESTIME NË RRJETET ENERGJETIKE

Investimet e realizuara në qarkun e Elbasanit nga ana e OSHEE, kanë transformuar rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike, duke ofruar furnizim më të mirë për banorët. Nga dy investimet e realizuara së fundmi, në Labinot dhe Përrenjas, kanë përfituar në total 17 mijë banorë si dhe një numër i madh biznesesh që operojnë në këtë zonë.

VORË, RINDËRTIMI I BANESAVE

Ka nisur puna për ndërtimin e banesave të dëmtuara nga tërmeti në zonën e Vorës. Prioritet janë familjet më në nevojë dhe më pas do të ndërhyhet në të gjitha banesat e dëmtuara. Familjet, banesat e të cilëve kanë qenë totalisht të pabanueshme, janë akomoduar në vendqëndrime të sigurta ndërsa ato të cilat nuk kanë pranuar të largohen nga banesat e tyre u janë ofruar çadra akomoduese.

SEGMENTI RRUGOR QAFË KASHAR-RINAS

Në segmentin rrugor Qafë Kashar - Rinas janë duke u realizuar një sërë ndërhyrjesh me qëllim rritjen e sigurisë rrugore në këtë aks. Aktualisht po punohet për vendosjen e barrierave mbrojtëse, përmirësimin e sinjalistikës horizontale dhe vertikale, lysterjen e bordurave, riparimin e fugave në mbikalime dhe ura si dhe pastrimin e kanaleve.